



Sa do të kushtojnë shërbimet e ofruara nga KPA-ja?



KPA-ja merr tarifën e saj nga pagesa mujore e qirasë deri në 5% për të mbuluar shpenzimet administrative të shërbimeve për qiradhënie të ofruara bartësit të së drejtës pronësore. Përveq kësaj, shpenzimet e tjera lidhur me pronën (sikurse sigurimet dhe tatimet) mund të zbriten në pajtueshmëri me ligjin e aplikueshëm.

Ju lutemi të keni parasysh tarifën ngarkuese nga bankat private për transferimin e të hollave në llogaritë tuaja bankare.



Brenda Kosovës tarifën janë të ulëta, por nëse ju kërkoni transfer në llogari bankare jashtë Kosovës, tarifën mund të jenë deri në €15 për transaksion.



Ju lutemi keni parasysh:

KPA-ja nuk u garanton të ardhura nga prona e juaj. Nëse prona nuk jepet me qira, nuk mund të priten të ardhura.

Nëse qiramarrësi nuk paguan, atëherë asnjë pagesë nuk do të transferohet tek ju. Nëse qiramarrësi nuk paguan atëherë KPA-ja do të ekzekutojë dëbimin nga prona dhe do të bëjë përpjekje të caktojë një qiramarrës të ri i cili do të pajtohet të paguajë qiranë.

KPA-ja nuk merr përgjegjësi për dëmtim të pronës gjatë një procesi të tillë të dëbimit. Nëse prona bëhet e pabanueshme gjatë procesit, KPA-ja do të kthejë posedimin e pronës bartësit të së drejtës pronësore.

DPCPB mbrojtë shtëpinë tuaj në Kosovë,

KPA-ja do t'a japë me qira për ju.

Beograd

Kosovska 49/8
Tel: 011 334 5513 ose 224 5314
Fax: 011 334 4452

Gjilan

Rade Popovic/Washington Street
Tel: 0280 20 289 - fax: 0280 24 067

Kragujevc

9, "Llolla Ribar" Rr. Kati 3të
Tel: 034 330-234; 330-784

Mitrovicë

Pjesa jugore: rr. Mbretëresha Teuta (përballë Jugobankës) 028 30 136 and 30137 - fax: 028 30 139
Pjesa Veriore: rr. Filip Vishnjq No. 4, Dhoma No. 18 (ish Ndërtesa e AKM), Stacioni Verior i Policisë
Tel: 063 197 6470 - fax: 028 30 139

Nish

rr. "Dusanov Bazar" (Dusanova)
Kati 3të, Zyrja No. 308
Tel: 018 515-727; 515-728

Pejë

rr. Bill Clinton, No. 54
Tel: 039 32 968 - fax: 039 32 970

Podgoricë

Crnogorskih Serdara
Tel: 081 624 216

Prishtinë

Qendër: Rexhep Luci 28/rr. Goleshit
2 Tel: 038 225 473 - fax: 038 244 854
Graçanicë: Prapa ndërtesës së komunës Tel: 038 225 473

Prizren

Jeronim Derada (ish Zef Mark Lushi/Metohisë) No. 63/A
Tel: 038 504 604 8046 - fax: 029 631 429

Shkup

rr. Vinichka No. 10 (ndërtesa CDRIM), kati i 1rë
Tel: +389 22 656 291



www.kpaonline.org
administrator@hpdkosovo.org

Fitoni të ardhura nga prona juaj në Kosovë!

Skema e qiradhënies së KPA-së



Agjencioni Kosovar Për Prona

Skema e qiradhënies e KPA-së



Çka është skema e qiradhënies?

Agjencioni Kosovar për Prona (KPA) është themeluar më 4 mars 2006 në bazë të Rregullores së UNMIK-ut 2006/10. Përveç detyrave të tjera, KPA-ja ka mandat të mbikëqyrë qiradhënien e pronave të braktisura në Kosovë.

Lidhur me këtë çështje, Agjencia e menaxhon skemën e qiradhënies për pronat nën administrimin e saj. Kjo skemë e bën të mundshme për bartësin e të drejtës pronësore për të marrë të ardhura fikse nga prona duke autorizuar KPA-në të japë atë me qira derisa ai/ajo vendos të shfrytëzojë pronën në ndonjë mënyrë tjetër.



Si t'i bashkoheni skemës së qiradhënies?



Pjesëmarrja në skemën e qiradhënies është vullnetare dhe e thjeshtë. Vetëm caktoni një vizitë në një nga zyret e KPA-së (shih listën në pjesën e prapme të kësaj broshure) dhe sillni me vete:

1. letërnjoftimin tuaj;
2. udhëzimin me shkrim të bankës tuaj se si të pranojnë pagesat në mënyrë elektronike nga ndonjë bankë në Kosovë;
3. adresën postare, numrin tuaj të telefonit mobil, nëse është e mundur edhe adresën elektronike. Pa këtë ne nuk mundemi të shqyrtojmë pagesat e qiradhënies.



Si do të merrni qiranë për pronën tuaj?



Qiraja mund të merret vetëm nëse qiramarrësi dëshiron të marrë me qira pronën tuaj. Prandaj, KPA-ja nuk është në gjendje të garantojë ndonjë pagesë – kjo varet tërësisht nga tregu i qiradhënies në zonën në të cilën gjendet prona juaj. Nëse prona nuk i është dhënë qiramarrësit, ju nuk do të merrni pagesë qiraje.

Vlera e qirasë është e caktuar nga KPA-ja në bazë të vlerës së tanishme të pronës siç është përcaktuar nga autoritetet komunale.



Prandaj, vlera e qiradhënies nuk është e diskutueshme as nga qiradhënësi e as nga qiramarrësi. Nëse mendoni që mundeni të merrni qira më të lartë për pronën tuaj në tregun privat, ju mund t'i jepni fund qiradhënies me KPA-në në çdo kohë (shih më poshtë).



Qiraja merret nga KPA-ja në baza mujore pas pagesës fillestare të depozitit dhe një muaji qira në avans. Nëse qiraja nuk paguhet, KPA-ja do të dëbojë qiramarrësin. Depoziti do të mbulojë qiranë potenciale të papaguar apo do t'i kthehet qiramarrësit në fund të kontratës së qiradhënies.



Kush është qiramarrësi?



Kur prona përfshihet në skemën e qiradhënies, ju e keni autorizuar KPA-në për të gjetur një qiramarrës. Ne do të reklamojmë pronën tuaj dhe do të bëjmë një kontratë mbi qiranë me qiramarrësin e sipas zgjedhjes sonë.



Si të përfundohet qiradhënia dhe tërheqja nga skema e KPA-së?

Ju mund të përfundoni kontratën e qiradhënies në çdo kohë duke njoftuar me shkrim KPA-në. Me udhëzim të tillë, ne do të njoftojmë qiramarrësin aktual dhe do të përfundojmë llogaritë. Ky proces mund të zgjasë deri në tre muaj.

